



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Fakulteti i Edukimit**

**Programi i studimit:  
PhD në Shkencat e Edukimit**

*Niveli i studimeve:*  
Doktoratë

*Numri i kredive:*  
180 ECTS

*Akredituar për periudhën:*  
1 Tetor 2015- 30 Shtator 2018

## **Përmbajtja:**

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	2
2. REZULTATET E PRITURA.....	3
3. PROGRAMI I STUDIMIT .....	5
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN MODUL .....	7

## 1.QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i përgjithshëm i këtij programi PhD do të jetë:

- të përgatisë ekspertë të edukimit, që do të përkrahin zhvillimin e sistemit arsimor dhe shkollor;
- të përgatisë mësimdhënës, që posedojnë shkathtësi dhe koncept për zhvillim bashkëkohor të edukimit;
- të përgatisë hulumtues të edukimit, që do të jenë të gjendje të shtyjnë idetë novatore në fushën e shkencave të edukimit.

Programi studimor i studimeve PhD, në radhë të parë, do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve në vijim:

- Thellimi i njohurive të kandidatëve në konceptet teorike dhe metodologjike në fushën e edukimit, mësimdhënies dhe shkencave të edukimit;
- Pajisja e kandidatëve me shkathtësi për të zhvilluar njohuri të reja në mënyrë të pavarur, në mënyrë që të mund të zgjidhin probleme të vështira profesionale dhe shkencore me një qasje ndërdisiplinore;
- Zhvillimi i shkathtësive për reflektim kritik dhe përgjegjësi etike i kandidatëve në hulumtim dhe kompetenca sociale e komunikimit për hulumtim dhe udhëheqje profesionale;
- Përgatitja e kandidatëve për të monitoruar (testuar, përmirësuar) në mënyrë kritike faktorët e njohur dhe për të ofruar zgjidhje të reja për fushat specifike dhe praktike;
- Përgatitja e kandidatëve për të udhëhequr hulumtimet shkencore dhe projektet profesionale, si dhe sistemet e kërkuara të punës.

Duke përdorur përshkruesin Dublin dhe kompetencat TUNING si pikë referuese për dizajnimin e programit, programi PhD do të orientohet drejt aftësimit të studentëve për të arritur kompetencat gjenerike dhe specifike të përshkruara më poshtë.

---

<sup>1</sup>Shiko Misioni- Fakulteti i Edukimit; Strategjia për zhvillimin e Fakultetit të Edukimit 2013/18.

## 2. REZULTATET E PRITURA

Zbatimi i këtij Programi PhD do të rezultojë në arritjen e *kompetencave gjenerike* në vijim:

- Njohuri të thellë të koncepteve teorike në fushën e filozofisë së edukimit, sociologjisë, psikologjisë, pedagogjisë dhe antropologjisë;
- Të kuptuar të lartë për qasjet e ndryshme hulumtuese në fushën e edukimit dhe fushat e ndërlidhura;
- Aftësi për të marrë vendim, formësuar dhe ekzekutuar një proces të gjerë hulumtues;
- Zgjidhje të problemeve të komplikuara, duke testuar dhe përmirësuar zgjidhjet e njohura dhe duke dizajnuar zgjidhje të reja;
- Aftësi për të kontribuar përmes hulumtimeve origjinale në zgjerimin e kufijve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të dijes;
- Aftësi për të analizuar në mënyrë kritike, vlerësuar dhe sintetizuar idetë komplekse;
- Aftësi për të kuptuar probleme komplekse të edukimit dhe për të gjetur zgjidhje për to;
- Pjesëmarrje një dialog kritik, inkurajim dhe udhëheqje të proceseve sociale brenda fushës profesionale;
- Kapacitet për kritikë dhe vetëkritikë;
- Përgatitje e kandidatëve për të udhëhequr projekte të hulumtimeve shkencore në fusha të gjera shkencore profesionale;
- Aftësi për të raportuar tek kolegët dhe komuniteti i gjerë shkencor dhe shoqëria në përgjithësi, ato elemente që i përkasin fushës së vet të ekspertizës;
- Aftësi për të prezantuar në mënyrë publike dhe për të mbrojtur punën shkencore;
- Aftësi për të ofruar progres përmes proceseve të bazuara në njohuri në ambientet akademike dhe profesionale;
- Kapacitet për të menduar kreativ dhe zgjidhje problemesh;
- Të kuptuar të etikës së hulumtimit dhe respektimi i kësaj etike;

### **Gjithashtu, në arritjen e kompetencave specifike në vijim:**

- Të njohurit dhe të kuptuarit e teorive dhe koncepteve teorike, paradigmave shkencore dhe zhvillimeve në fushën e mësimdhënies dhe shkencave të edukimit;
- Të kuptuarit e thellë të metodave të hulumtimit cilësor dhe sasior, si dhe aftësia për t'i përdorur këto metoda në fushën e vet të ngushtë të ekspertizës;
- Zhvillimi i përgjegjësisë personale dhe nivelit të lartë të iniciativave të pavarura, në situata komplekse dhe të paparashikuara, në ambientet profesionale apo të ndërlidhura me edukim, në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë të çështjes;
- Vështrimi kritik i implikimeve të gjera, duke përdorur njohuri në ambientet profesionale dhe edukative;
- Analizimi i detajuar dhe reflektimi mbi normat sociale dhe marrëdhëniet brenda fushës specifike në tezën PhD, duke udhëhequr aktivitete për ta transformuar dhe duke ndërmjetësuar mes hulumtimeve shkencore dhe ambienteve sociale;
- Aftësia për të zbuluar problemet praktike në fushën e tyre, që mund të zgjidhen me metoda dhe mjete shkencore hulumtuese;
- Aftësia për të udhëhequr një hulumtim origjinal në një fushë përkatëse;
- Aftësia për të hartuar dhe publikuar punë hulumtuese origjinale dhe të pavarur;
- Kapaciteti për të mësuar bashkëpunues, komunikim kreativ në ambient hulumtues dhe zgjidhje problemesh në bashkëpunim me ekipet multidisiplinare.

### 3. PROGRAMI I STUDIMIT

#### VITI I PARË

##### SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Teoritë bashkëkohore në fushën e shkencave të edukimit	O	10+15	5
2.	Kurs i avancuar në metodat e hulumtimit në edukim	O	10+15	5
3.	Seminar Doktorate I	O	0+30	5
4.	Modul i studimit të orientuar I	O	10+15	5
5.	Modul i shkrimit të Disertacionit	O	10+15	5
6.	Modul i hulumtimit individual	O		5
<b>Gjithsej</b>			<b>40+90</b>	<b>30</b>

##### SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Trendet bashkëkohore në hulumtimin në edukim	O	10+15	5
2.	Seminar Doktorate II	O	0+30	5
3.	Modul i studimit të orientuar II	O	10+15	5
4.	Modul zgjedhor	O	10+15	5
5.	Modul zgjedhor	O	10+15	5
6.	Modul i hulumtimit individual	O		5
<b>Gjithsej</b>			<b>40+90</b>	<b>30</b>

#### VITI I DYTË

##### SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Seminar Doktorate III			5
2.	Modul zgjedhor		10+15	5
3.	Modul i hulumtimit individual			20
<b>Gjithsej</b>			<b>10+15</b>	<b>30</b>

##### SEMESTRI IV

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Modul i hulumtimit individual	O		30
<b>Gjithsej</b>				<b>30</b>

## VITI I TRETË

### SEMESTRI V

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Modul i hulumtimit individual	O		30
	<b>Gjithsej</b>			<b>30</b>

### SEMESTRI VI

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Modul i hulumtimit individual	O		30
	<b>Gjithsej</b>			<b>30</b>

#### Studimi i orientuar dhe modulet zgjedhore

Programi përmban module të studimit të orientuar (kandidati i zgjedh dy module të tilla) dhe module zgjedhore (kandidati i zgjedh 3 module).

#### Modulet e studimit të orientuar:

Nr.	Lënda
1.	Mësimdhënia dhe të mësuarit I dhe II
2.	Mësimdhënia e shkencave natyrore I dhe II
3.	Mësimdhënia e matematikës I dhe II
4.	Mësimdhënia e shkencave shoqërore I dhe II
5.	Edukimi inkluziv I dhe II
6.	Edukimi parashkollor I dhe II
7.	Udhëheqja në arsim I dhe II

#### Modulet zgjedhore-( Kandidatët zgjedhin 3 module: 3X5 ECTS )

Nr.	Lënda
1.	Hulumtimi cilësor
2.	Hulumtimi sasior
3.	Shkrimi i artikujve shkencor dhe prezantimi i rezultateve
4.	Kurs i avancuar në edukimin special
5.	Kurs i avancuar në komunikimin në arsim
6.	Psikologji e stresit
7.	Zhvillimi profesional i mësimdhënësit
8.	Kurs i avancuar për vlerësimin në arsim
9.	Edukimi ndërkombëtar
10.	Politikat arsimore
11.	Këshillimi individual dhe organizativ
12.	Mësimdhënia dhe mësimnxënia në arsimin e lartë

#### 4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN MODUL

Përshkrimi për secilin modul	
1	<p><b>Teoritë bashkëkohore në fushën e shkencave të edukimit</b></p> <p>Pjesëmarrësit në këtë modul fitojnë një pasqyrë mbi diversitetin e koncepteve teorike, në të cilat bazohet puna kërkimore në fushën e shkencave edukative, si dhe fitojnë aftësi për trajtimin ndërdisiplinor, multidisiplinor dhe transdisiplinor të problemeve kërkimore. Moduli përfshin një shqyrtim të thellë të perspektivave përkatëse specifike disiplinore, bazohet në këto, kur orientohet drejt perspektivave më të gjera mbi problemin. Kështu, pjesëmarrësit aftësohen për të njohur problemet më të gjera, të cilat nga kjo perspektivë i lidhin me kontekstin më të gjerë të temës së disertacionit të doktoratës së tyre, ndërsa në të njëjtën kohë kërkojnë zgjidhje të reja konceptuale për problemet e identifikuara. Moduli do t'i ekspozojë studentët para trendeve të fundit në debatet ndërkombëtare të teorive mbi zhvillimet në arsim, me një fokus në zhvillimin e perceptimeve për rolin e mësimdhënësve, qëllimet e shkollimit dhe reformën e arsimit, shqyrtuar kundrejt një grupi të larmishëm të teorive dhe filozofive të arsimit.</p>
2	<p><b>Kurs i avancuar në metodat e hulumtimit në shkencat e edukimit</b></p> <p>Qëllimi i këtij moduli është që të ndërtohet mbi njohuritë metodologjike dhe statistikore, tashmë të fituara në studimet dhe përvojën e mëparshme të kandidatëve, pastaj të zgjerohen dhe thellohen këto njohuri me metodat dhe qasjet, që janë veçanërisht të rëndësishme për kërkime në fushën e shkencave të edukimit. Qëllimi i modulit është të aftësojë pjesëmarrësit të planifikojnë në mënyrë të pavarur dhe të kryejnë kërkime empirike përfshirë: konceptualizimin e duhur dhe studimin e situatës aktuale në një fushë të caktuar (në lidhje me qasjet e ndryshme ontologjike dhe epistemologjike), formulimin e pyetjeve kërkimore të bazuara në teori dhe përzgjedhjen e qasjeve dhe metodave të përshtatshme kërkimore, analizimin dhe interpretimin e të dhënave dhe gjenerimin e konkluzioneve të rëndësishme për zbatim në procesin arsimor. Moduli do të trajtojë çështjet e etikës në kryerjen e hulumtimeve në edukim.</p>
3	<p><b>Trendet bashkëkohore në hulumtimin në edukim</b></p> <p>Qëllimi i këtij moduli është studimi dhe analiza e tendencave bashkëkohore në kërkime në fushën e arsimit të mësuesve dhe shkencat arsimore. Pjesëmarrësit analizojnë në mënyrë empirike ose teorike specifike shqiptare dhe ndërkombëtare, relevante për punën e tyre individuale kërkimore: supozimet teorike, pyetjet kërkimore, çështjet e zbatimit dhe interpretimit, si dhe publikimin dhe përdorimin e rezultateve. Në kuadër të modulit, pjesëmarrësit zhvillojnë aftësinë për të integruar</p>



	<p>konceptet teorike dhe teoritë, njohuritë kërkimore-metodologjike dhe përvojën praktike, si dhe zhvillimin e një aftësie për (vetë) reflektim mbi dhe (vetë) kritikë të punës kërkimore.</p>
4	<p><b>Seminar Doktorate I</b></p> <p>Qëllimi i seminarit të doktoratës është të krijojë një mjedis bashkëpunues studimi, në të cilin studentët e doktoratës takohen dhe bashkëpunojnë. Studentë paraqesin propozimet e tyre të doktoratës para kolegëve. Të angazhuar në dialog kritik, pjesëmarrësit kontribuojnë me vështrimet, mendimet dhe gjetjet e tyre në propozimet e paraqitura. Seminari i doktoratës I do të fokusohet në formulimin e problemeve kërkimore dhe shqyrtim të literaturës, si dhe zhvillimin e propozimeve kërkimore, si dhe proceset e përgjithshme dhe pritshmëritë e përfundimit të një Programi PhD.</p>
5	<p><b>Seminar Doktorate II</b></p> <p>Qëllimi i seminarit të doktoratës është të krijojë një mjedis bashkëpunues studimi, në të cilin studentët e doktoratës takohen dhe bashkëpunojnë. Studentë paraqesin propozimet e tyre e doktoratës para kolegëve. Të angazhuar në dialog kritik, pjesëmarrësit kontribuojnë me vështrimet, mendimet dhe gjetjet e tyre mbi tezat e prezantuara, të gjeturat nga këto teza dhe proceset e kërkimit që ndërmerren nga studentët, varësisht nga progresi i secilit student individualisht. Seminari i Doktoratës II do të fokusohet në zhvillimin e instrumenteve dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave.</p>
6	<p><b>Seminar Doktorate III</b></p> <p>Qëllimi i seminarit të doktoratës është të krijojë një mjedis bashkëpunues studimi, në të cilin studentët e doktoratës takohen dhe bashkëpunojnë. Studentë paraqesin propozimet e tyre e doktoratës para kolegëve. Të angazhuar në dialog kritik, pjesëmarrësit kontribuojnë me vështrimet, mendimet dhe gjetjet e tyre mbi tezat e prezantuara, të gjeturat nga këto teza dhe proceset e kërkimit që ndërmerren nga studentët. Seminari i Doktoratës III do të fokusohet në interpretimin e të dhënave dhe prezantimin e rezultateve të hulumtimit, varësisht nga progresi i secilit student individualisht.</p>
7	<p><b>Mësimdhënia dhe të mësuarit I &amp; II</b></p> <p>Ky modul është një kurs i avancuar i psikologjisë së të mësuarit dhe pedagogjisë; brenda këtij moduli studentët do të diskutojnë konceptet kyçe psikologjike dhe pedagogjike, të lidhura me të arriturat individuale akademike - strukturat kognitive, stilet kognitive, aftësitë, motivimin për të mësuar, dhe personalitetit. Studentët do të punojnë në projekte të zgjedhura kërkimore kontekstuale dhe do të prezantojnë të gjeturat e tyre në grup.</p>

8	<p><b>Mësimdhënia e shkencave natyrore I &amp; II</b></p> <p>Pjesëmarrësit në këto module fitojnë një pasqyrë mbi kontekstin historik, zhvillimor dhe konceptual, në të cilin është bërë dhe vazhdon të bëhet zhvillimi i metodave, qasjeve dhe zbatimi i temave të mësimdhënies dhe të nxënimit të përmbajtjes së shkencave natyrore. Moduli do të përshtatet me specifikat e profileve të studentëve, për t'iu ndihmuar atyre të thellojnë të kuptuarit e fushës së tyre të interesit.</p>
9	<p><b>Mësimdhënia e matematikës I &amp; II</b></p> <p>Kursi përmban temat në vijim: përfaqësimi e ideve matematikore sipas teorive të Bruner, Dienes, Skemp dhe hulumtuesve bashkëkohorë në fushat në vijim: të mësuarit e matematikës me të kuptuar të rolit të transformimit të përfaqësimeve implicite në eksplicite dhe përkthimeve në mes të këtyre përfaqësimeve; edukimi real matematikor si aplikim i teorisë konstruktiviste në praktikë; zgjidhja e problemeve në matematikë - strategjitë, orientimet, arsyetimi induktiv, skemat e zgjidhjes së problemeve (të zhvilluara mirë dhe pjesërisht - në lidhje me asimilimin dhe akomodimin). Të gjitha temat do të diskutohen nga këndvështrimi i mësimdhënies së matematikës.</p>
10	<p><b>Mësimdhënia e shkencave shoqërore I &amp; II</b></p> <p>Në kuadër të këtyre moduleve studentët njoftohen me didaktikën e shkencave shoqërore, si një sintezë e dijes pedagogjike nga disipinat individuale apo të integruara të shkencave shoqërore, fitojnë njohuri për rëndësinë aplikative të didaktikës së shkencave shoqërore nga perspektiva e kompetencës së nxënësve. Ata marrin përsipër një krahasim ndërkombëtar të zhvillimit të kurrikulës së shkencave shoqërore, me theks në nivelet fillore dhe problemet aktuale të mësimimit të shkencave shoqërore në përgjithësi dhe në Kosovë, si dhe qasjet në zgjidhjen e këtyre problemeve.</p>
11	<p><b>Edukimi inkluziv I &amp; II</b></p> <p>Pjesëmarrësit në këtë modul do të fitojnë dhe të zhvillojnë të kuptuarit mbi, dhe një aftësi për të zbatuar, gjithëpërfshirjen në të gjithë fushën e arsimit, duke përfshirë reflektimet e gjithëpërfshirjes në politikat e edukimit, sistemin, shkollën dhe klasën. Duke u bazuar në përkatësinë dhe përvojën e tyre paraprake, pjesëmarrësit thellojnë dhe lidhin njohuritë e tyre të konceptit të gjithëpërfshirjes dhe kushteve që sigurojnë procese përfshirëse; ata zhvillojnë një kapacitet për reflektim kritik mbi proceset, qëndrimet, situatat dhe faktorët tjerë që mundësojnë (ose pamundësojnë) dhe/ ose inkurajojnë (ose pengojnë) gjithëpërfshirjen.</p>
12	<p><b>Edukimi parashkollor I &amp; II</b></p>

	<p>Brenda kornizës së vet, këto module trajtojnë konceptet tradicionale dhe bashkëkohore të fëmijërisë dhe edukimit nga këndvështrimi i shkencave të ndryshme, analizat krahasuese e të kërkimeve nga fusha e fëmijërisë, treguesit e arsimimit parashkollor cilësor në kopshtin e fëmijëve, të gjeturat nga studimet e fëmijërisë së hershme dhe zbatimin e tyre në praktikën parashkollore.</p>
13	<p><b>Udhëheqja në arsim I &amp; II</b></p> <p>Modulet do të bazohen në ekspozimin e studentëve ndaj vështrimeve (pikëpamjeve) të thella në literaturë dhe ndaj debateve të fundit në udhëheqjen dhe ndryshimet në arsim. Modulet do të mbulojnë fushat e teorive dhe praktikave të udhëheqjes, si dhe do të përqendrohen në zhvillimin individual dhe organizativ në arsim. Çështjet e rritjes së performancës dhe ndryshimeve organizative, teoritë dhe praktikat kryesore të ndryshimit do të jenë tema të rëndësishme në këtë kurs. Moduli I &amp; II do të specifikohet qartë në programet mësimore të kurseve dhe ligjëruesit do të planifikojnë një ndarje të qartë të çështjeve dhe literaturës, që do të mbulohet në secilin modul.</p>
14	<p><b>Shkrimi i artikujve shkencor dhe prezantimi i tyre</b></p> <p>Qëllimi i këtij moduli është të aftësojë pjesëmarrësit për të shkruar tekste shkencore dhe për t'i prezantuar këto tekste para audiencës profesionale. Pjesëmarrësit njihen me karakteristikat e përgjithshme të të shkruarit shkencor dhe me specifikat e disiplinave të veçanta në fushën e arsimimit të mësuesve dhe në fushën e shkencave arsimore. Moduli do të njoftojë studentët me të shkruarit e abstrakteve për konferenca dhe artikujve për revista të shqyrtuara.</p>
15	<p><b>Hulumtimi cilësor</b></p> <p>Moduli do të njoftojë pjesëmarrësit më në thellësi me dizajnet dhe qasjet e ndryshme të kërkimeve cilësore. Fokus i veçantë i këtij moduli do të jetë shqyrtimi i pikëpamjeve teorike dhe praktike të: etnografisë, fenomenologjisë, studimit të rastit, teorisë së bazuar, hermeneutikës dhe dizajneve të tjera cilësore. Moduli do të ketë një fokus të veçantë në metodat e analizës së të dhënave cilësore, me qëllim të ndihmuarit e studentëve për të kryer hulumtimin e tyre për disertacion.</p>
16	<p><b>Hulumtimi sasior</b></p> <p>Ky modul do të njoftojë pjesëmarrësit më në thellësi me dizajnet e ndryshme dhe qasjet në hulumtim sasior. Pjesëmarrësve do t'u ofrohet një mundësi për të reflektuar dhe për t'u angazhuar në dizajnimin e kërkimeve sasiore- eksperimentale, kuazi-eksperimentale, hartimin e anketave dhe të ngjashme. Moduli do të ketë një fokus të veçantë në hartimin e instrumenteve kërkimore sasiore, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e tyre. Një komponent thelbësor i këtij moduli është përdorimi i programit</p>

	SPSS për analizim të të dhënave sasiore.
17	<p><b>Kurs i avancuar në komunikimin në arsim</b></p> <p>Moduli do t'u ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për të reflektuar në fushën e modaliteteve, mundësive dhe tendencave në komunikim në sektorin e arsimit. Moduli do të ketë një fokus të veçantë në marrëdhëniet dhe kujdesin në arsim, si dhe do të ofrojë një mundësi për analizë kritike të literaturës në fushën e komunikimit mes aktorëve të ndryshëm në sistemin arsimor, duke përfshirë bashkëpunimin e sistemit shkollor me prindërit dhe komunitetin.</p>
18	<p><b>Psikologji e stresit</b></p> <p>Moduli do t'u ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për të shqyrtuar çështjet e mirëqenies në arsim, me fokus të qartë në stresin, djegien profesionale dhe strategjitë përballuese në fushën e mësimdhënies. Do të ofrohen strategji të ndryshme të menaxhimit të stresit për lojtarët kyç në arsim. Pjesëmarrësit do të kenë një mundësi për shqyrtim kritik të literaturës në fushën e stresit dhe efektet e tij në proceset arsimore, me një fokus në mësimdhënie.</p>
19	<p><b>Zhvillimi profesional i mësimdhënësit</b></p> <p>Moduli do t'u ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për të shqyrtim të thelluar mbi modelet e ndryshme të zhvillimit profesional dhe zgjedhjet që mund të bëjnë menaxherët e shkollave dhe sistemeve të arsimit, në funksion të zhvillimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, si një mjet për përgatitje profesionale të mësuesve. Moduli do të vërë në dukje për pjesëmarrësit debatet e kohëve të fundit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, zhvillimin efektiv profesional, një sistem koherent të zhvillimit të mësimdhënësve, si dhe lidhjet e këtij sistemi me punën e shkollës dhe arritjet arsimore.</p>
20	<p><b>Kurs i avancuar për vlerësimin në arsim</b></p> <p>Moduli do të ndërtohet mbi njohuritë paraprake të pjesëmarrësve dhe përvojën në fushën e vlerësimit. Moduli do të fokusohet në rishikimin e debateve në literaturë dhe implikimet praktike në fushën e vlerësimit të bazuar në shkollë, vlerësimet e jashtme të standardizuara, si dhe vendosjen e standardeve të vlerësimit. Moduli do të pajisë studentët me mundësi që të angazhohen në shqyrtimin e vetë sistemit të vlerësimit në vend, bazuar në literaturën që ata shqyrtojnë.</p>
21	<p><b>Kurs i avancuar në edukimin special</b></p> <p>Qëllimi i këtyre moduleve është që të njoftojë pjesëmarrësit me trendet bashkëkohore në praktikën arsimore gjithëpërfshirëse dhe në kërkimet në fushën e</p>

	<p>arsimit special dhe rehabilitues. Pjesëmarrësit do të angazhohen për të ngritur sasinë, cilësinë dhe novacionet e punës shkencore dhe zhvillimore në fushën e arsimit special dhe rehabilitues. Planifikimi individual i arsimit dhe puna me studentë të talentuar do të mbulohet nën këtë modul.</p>
22	<p><b>Edukimi ndërkombëtar</b></p> <p>Moduli do t'i ekspozojë studentët ndaj tendencave më të rëndësishme në fushën e arsimit ndërkombëtar. Rezultatet e vlerësimeve ndërkombëtare të tilla si PISA, TIMMS, PIRLS do të përpunohen dhe do trajtohen implikimet që këto kanë në zhvillimin e arsimit. Përveç kësaj, moduli do të shqyrtojë tendencat dhe analizat e aktorëve të mëdhenj të arsimit si UNESCO, Banka Botërore dhe OSBE dhe aktivitetet e ndryshme të standardizimit dhe analizave që këta i menaxhojnë në lidhje me zhvillimin e arsimit. Moduli do të ekspozojë studentët ndaj sistemeve të mira të arsimit nëpër botë dhe shembujve të kontinenteve të ndryshme, me fokus të qartë në lidhjet mes kulturës dhe arsimit (përfshirë mostra të modeleve të edukimit si aziatike, skandinave, të Evropës Perëndimore dhe anglo-saksone).</p>
23	<p><b>Politikat e arsimit</b></p> <p>Pjesëmarrësit thellojnë të kuptuarit e marrëdhënieve në mes disiplinave të ndryshme akademike dhe të politikave arsimore, praktikat dhe konceptualizimet e tyre disiplinore dhe ndërdisiplinore, si dhe vlerësimet dhe reflektimet. Pjesëmarrësit thellojnë njohuritë e tyre të koncepteve dhe paradigmeve teorike në arsim dhe hulumtim, duke reflektuar mbi fushat konkrete të politikave arsimore dhe zhvillojnë një kapacitet për reflektim kritik mbi marrëdhënien e sferës akademike me politikat arsimore, dhe atë të politikave arsimore me konceptualizimet teorike. Moduli do të vërë në dukje, për studentët, ciklin e politikave, duke përfshirë një orientim praktik për hartimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin e tyre.</p>
24	<p><b>Këshillimi individual dhe organizativ</b></p> <p>Moduli do t'i përgatisë pjesëmarrësit për të bërë lidhjet mes literaturë mbi këshillimin individual dhe organizativ, duke përfshirë praktikat e mentorimit në shkolla. Moduli do të mbulojë fushat e këshillimit të studentëve, rritjen e performancës dhe aspekte të zhvillimeve organizative. Moduli do të trajtojë konceptualizimet nga literatura për nevojën për udhëheqje efektive profesionale dhe këshillim psikologjik të nxënësve në mjedis shkollor.</p>
25	<p><b>Mësimdhënia dhe mësimnxënia në arsimin e lartë</b></p> <p>Qëllimi i këtij moduli është që të pajisen studentët me njohuri dhe të kuptuar dhe shkathtësi për çështjet e mësimdhënies dhe mësimnxënies në arsimin e lartë. Më saktë, moduli fokusohet edhe në çështjet e punës së një mësimdhënësi në Fakultetin e</p>

Edukimit. Temat përfshijnë çështjet si: shkathtësitë për të qenë profesor i edukimit, procesi dhe çështjet e zhvillimit të programeve dhe kurseve, planifikimi i sillabuseve, si dhe vlerësimi i studentëve në arsimin e lartë.